



UNMIK/REG/2007/30
16 tetor 2007

RREGULLORE NR. 2007/30

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 2000/45 MBI VETËQEVERISJEN E
KOMUNAVE TË KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999, mbi autoritetin e Misionit të Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren nr. 2000/1 të datës 14 dhjetor 2000 mbi Strukturën e Përbashkët Administrative të Kosovës,

Me qëllim të organizimit dhe mbikëqyrjes së zhvillimit të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisjen demokratike dhe autonome të Kosovës deri në vendimin politik të statusit përfundimtar të Kosovës,

Duke iu referuar Kartës Evropiane mbi Vetëqeverisjen Lokale, e veçmas nenit 3 i cili përcakton të drejtat dhe kompetencat e organeve lokale, brenda kufijve të ligjit, për të rregulluar dhe udhëhequr një pjesë substanciale të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të popullatës vendore,

Duke marrë parasysh Konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe protokollat e tyre, Kartën Evropiane për gjuhët rajonale ose të pakicave, Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas,

Duke marrë parasysh Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut nr. 2001/9),

Me qëllim të paraqitjes së kryetarit të komunës i cili zgjidhet drejtpërdrejt dhe ndryshimeve të tjera legjislative që burojnë nga kjo,

Me anë të kësaj ndryshon Rregulloren nr. 2000/45 të datës 11 gusht 2000 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë,

Si pasojë, Rregullorja e ndryshuar do të paraqitet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje,

Kapitulli 1 **Dispozitat e përgjithshme**

Neni 1 Institucionet e përkohshme

Me këtë Rregullore themelohen institucionet e përkohshme për vetëqeverisje demokratike dhe autonome.

Neni 2 Komunat në Kosovë

2.1 Njësia themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale në Kosovë është komuna, e cila ushtron tërë pushtetin, i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm apo ndarë organit kompetent qeveritar në pajtim me ligjin në fuqi.

2.2 Komunat rregullojnë dhe udhëheqin çështjet publike në territorin e tyre brenda kufijve të përcaktuar me ligj, për të siguruar kushte për jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e Kosovës. Ato mund të kujdesën për çështje me interes të përgjithshëm që kanë të bëjnë me komunën dhe të cilat nuk janë vetëm në kompetencë të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm apo nuk i janë caktuar organit kompetent qeveritar në pajtim me ligjin në fuqi.

2.3 Të gjitha organet dhe instancat e komunës kujdesen që banorët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendim tjetër, prejardhjeje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta të barabarta dhe të drejta për punësim në shërbimet komunale të të gjitha niveleve. Komunat me politikën dhe praktikën e tyre do të ndihmojnë në mbështetjen e bashkëjetesës mes banorëve dhe të krijimit të kushteve adekuate për t'u mundësuar të gjitha komuniteteve që ta shprehin, ruajnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor. Në këtë Rregullore, termi "bashkësitë" nënkupton bashkësitë e banorëve që i përkasin grupit të njëjtë etnik, fetar ose gjuhësor.

2.4 Çdo komunë e ka statusin e vet juridik, të drejtën për të poseduar dhe administruar pronën, mundësinë për të ushtruar padi dhe për të qenë i paditur në gjykata, të drejtën për të lidhur kontrata dhe të drejtën për të marrë punëtorë në punë.

2.5 Ndryshimet e kufijve administrativ të komunave mund të bëhen vetëm nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në pajtim me Kornizën Kushtetuese, pas konsultimeve me komunat përkatëse.

Neni 3

Përgjegjësitë dhe pushteti i komunave

3.1. Çdo komunë brenda territorit të vet dhe brenda ligjeve ekzistuese që rregullojnë secilin aktivitet është përgjegjëse për aktivitetet vijuese:

- (a) Ofrimin e kushteve themelore lokale për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- (b) Planifikimin urban dhe të fshatit dhe shfrytëzimin e tokës;
- (c) Lëshimin e lejeve për ndërtim dhe zhvillime të tjera;
- (d) Mbrojtjen lokale të ambientit;
- (e) Zbatimin e rregullave të ndërtimit dhe kontrollimin e standardeve të ndërtimit;
- (f) Ofrimin e shërbimeve publike lokale dhe të infrastrukturës duke përfshirë furnizimin me ujë, ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujerave të zeza, mirëmbajtjen e rrugëve lokale, transportin lokal dhe planet për ngrohtoret lokale;
- (g) Shërbimet publike duke përfshirë shërbimin e zjarrfikësve dhe të emergjencës;
- (h) Menaxhimin e pronës komunale;
- (i) Shkollimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- (j) Kujdesin shëndetësor primar;
- (k) Shërbimet sociale dhe strehimin;
- (l) Mbrojtjen e konsumatorëve dhe shëndetin publik;
- (m) Lëshimin e lejeve për shërbime dhe pajisje, duke përfshirë argëtimin, ushqimin, tregjet, shitjet në rrugë, transportin publik lokal dhe shërbimin e taksistëve, gjuetinë e peshkimit, restorantet dhe hotelet;
- (n) Panairot dhe tregjet;
- (o) Emërimin dhe riemërimin e rrugicave, rrugëve dhe vendeve të tjera publike;
- (p) Sigurimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave dhe

(q) Aktivitete tjera të ngjashme të nevojshme për administrimin adekuat të komunës, që nuk janë të përcaktuar gjetiu me ligj.

3.2 Përveç aktiviteteve të caktuara me nenin 3.1, komunat mund të ndërmarrin veprime në territorin e tyre edhe rreth çështjeve të tjera komunale. Këtu mund të përfshihen aktivitetet vijuese:

- (a) Turizmi;
- (b) Aktivitetet kulturore;
- (c) Sportet dhe aktivitetet e lira;
- (d) Aktivitetet e rinisë;
- (e) Avancimi i ekonomisë dhe
- (f) Avancimi i vlerave qytetare.

3.3 Komuna është gjithashtu përgjegjëse për zbatimin e ligjit në fuqi, duke përfshirë të dhënat kadastrale, regjistrat e popullsisë, regjistrimin e votuesve dhe regjistrimin e bizneseve. Për realizimin e këtyre qëllimeve komunës i sigurohen burimet përkatëse nga Qeveria.

3.4 Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes mund t'i delegojnë komunës përgjegjësi shtesë që i kanë në kuadër të kompetencave të tyre, me kusht që komunës t'i sigurohen burimet financiare përkatëse.

3.5 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mund të mbikëqyrë nëse veprimet apo vendimet që i ndërmarrin komunat janë në përputhje me ligjin në fuqi, duke ushtruar mbikëqyrje administrative në pajtim me Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/19.

3.6 Përveç për çështjet e saktësuara në kapitullin 2, neni 11.3, komunat në bashkëpunim me njëra tjetrën mund të lidhin marrëveshje për ushtrimin e cilësdo nga përgjegjësitë dhe kompetencat e veta.

Neni 4

Rregulloret lokale të komunës

4.1 Komunat mund të nxjerrin rregullore lokale të komunës dhe të marrin vendime specifike që u përkasin çështjeve përbrenda kompetencave të komunës. Statuti i komunës siguron miratimin dhe publikimin e tyre pas konsultimit publik.

4.2 Asnjë rregullore lokale e komunës nuk mund të jetë e vlefshme nëse është në konflikt me ligjin në fuqi.

Neni 5

Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane

5.1 Çdo komunë, brenda territorit të vet, bën marrëveshje me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane përbrenda territorit të saj, në mënyrë që të sigurojë përmbushjen e nevojave të gjithë banorëve në komunë.

5.2 Me pëlqimin e komunës, fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, ashtu siç janë përkufizuar në Statutin e komunës, vetëm apo në grupe mund të ushtrojnë aktivitete që janë në përgjegjësinë dhe kompetencën e komunës. Në këtë rast, fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane marrin fonde gjegjëse nga komuna. Nëse komuna nuk e miraton kryerjen e aktiviteteve të tilla, atëherë fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane mund të kërkojnë kontroll gjyqësor të vendimit të komunës në gjykatën kompetente.

5.3 Statuti dhe rregulloret lokale të komunës duhet të përcaktojnë formën e bashkëpunimit ndërmjet komunës e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane lidhur me vëllimin e punës, organizimin e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Të gjitha fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane duhet t'i përmbahen ligjit në fuqi kur ndërmarrin aktivitete në marrëveshje me komunën.

Neni 6

Organizatat jofitimprurëse

6.1 Komuna mund ta përkrahë funksionimin e organizatave jofitimprurëse, duke përfshirë shoqatat e anëtarëve të komuniteteve, nëse organizatat e tilla ofrojnë shërbime në kuadër të përgjegjësisë së përgjithshme të komunës.

6.2 Komuna mund të bëjë marrëveshje me cilëndo organizatë të tillë me qëllim të ofrimit të shërbimeve. Kur i ofrojnë shërbime komunës të gjitha organizatat e tilla duhet t'i përmbahen ligjit në fuqi

Neni 7

Mbledhjet dhe dokumentacioni

7.1 Në pajtim me nenin 7.3, në të gjitha mbledhjet e kuvendit komunal dhe komiteteve të tij dhe në të gjitha mbledhjet e Bordit të drejtorëve lejohet pjesëmarrja e publikut, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e shtypit.

7.2 Çdo person mund të kontrollojë dokumentet e komunës në pajtim me ligjin në fuqi mbi qasjen në dokumentet zyrtare.

7.3 Komitetet e Kuvendit komunal dhe Bordi i drejtorëve, përjashtimisht mund të vendosin për përjashtimin e publikut nga e tërë apo një pjesë e mbledhjes, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e medieve, çdoherë kur natyra e çështjes që diskutohet mund të marrë përmasa që mund të jenë të dëmshme për interesin e përgjithshëm publik.

7.4 Statuti mund të sigurojë pjesëmarrjen e publikut në mbledhje.

Neni 8
Tubimet publike dhe peticionet

8.1 Çdo komunë duhet të organizojë tubime publike periodike, së paku dy herë në vit, në të cilat mund të marrin pjesë të gjithë njerëzit apo subjektet e interesuara për komunë n. Data dhe vendi i tubimit shpallen së paku dy javë para takimit. Në tubim, përfaqësuesit e komunave i informojnë pjesëmarrësit për aktivitetin e komunës dhe pjesëmarrësit mund t'u shtrojnë pyetje dhe t'u japin propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal.

8.2 Çdo person apo organizatë që ka interes në komunë ka të drejtë t'i paraqesë peticion kuvendit komunal për çfarëdo çështje që ka të bëjë me përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Kuvendi komunal e shqyrton peticionin në pajtim me Statutin dhe Rregulloren e punës.

Neni 9
Gjuhët

9.1 Anëtarët e bashkësive kombëtare kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhën e tyre me të gjitha organet e komunës dhe me të gjithë nëpunësit civilë të komunës.

9.2 Mbledhjet e kuvendit të komunës dhe të komiteteve të tij dhe mbledhjet e Bordit të drejtorëve dhe të gjitha tubimet publike, të konvokuara sipas nenit 8 mbahen në të dy gjuhët: shqip dhe serbisht. Në komunat ku gjuha e komuniteteve nuk është as shqipja as serbishtja, aktet dhe procesverbalet gjithashtu duhet të përkthehen në gjuhën e këtyre komuniteteve sa herë që paraqitet nevoja.

9.3 Të gjitha dokumentet zyrtare të komunës shtypen në dy gjuhë: shqip dhe serbisht. Në komunat ku jetojnë komunitetet, gjuha e të cilave nuk është as shqipja e as serbishtja, të gjitha dokumentet zyrtare shtypen edhe në gjuhën e këtyre komuniteteve.

9.4 Shenjat zyrtare që tregojnë ose mbajnë emrat e qyteteve, qytezave, fshatrave, udhëve, rrugëve dhe vendeve të tjera publike ja në në gjuhën shqipe dhe serbe. Në komunat ku jeton një komunitet, gjuha e të cilit nuk është as shqipja e as serbishtja, ata emra duhet të jepen edhe në gjuhën e këtij komuniteti.

9.5 Statuti i komunës duhet të përfshijë dispozita të detajuara për përdorimin e gjuhës së komuniteteve ashtu siç parashihet në këtë nen, duke marrë parasysh strukturën e komuniteteve në komunë.

Kapitulli 2
Kuvendi komunal dhe komitetet e tij

Neni 10
Zgjedhja e kuvendit komunal

10.1 Organi më i lartë përfaqësues i komunës është kuvendi komunal dhe ai zgjidhet në mënyrë direkte. Pushteti dhe detyrat e komunës ushtrohen nga kuvendi komunal dhe organet e tij, përveç rasteve kur me këtë Rregullore përcaktohet ndryshe.

10.2 Numri i këshilltarëve të kuvendit komunal në komuna është si vijon:

Prishtinë/Priština	51
Podujevë/Podujevo	41
Prizren/Prizren	41
Suharekë/Suva Reka	41
Gjakovë/Đakovica	41
Pejë/Pec	41
Mitrovicë/Mitrovica	41
Gjilan/Gnjilane	41
Ferizaj/Uroševac	41
Malishevë/Mališevo	31
Gllgovc/Glogovac	31
Lipjan/Lipljan	31
Rahovec/Orahovac	31
Deçan/Decani	31
Istog/Istok	31
Klinë/Klina	31
Skenderaj/Srbica	31
Vushtri/Vucitrn	31
Kaçanik/Kacanik	31
Kamenicë/Kamenica	31
Viti/Vitina	31
Fushë Kosovë/Kosovo Polje	21
Obiliq/Obilic	21
Shtime/Štimlje	21
Dragash/Dragaš	21
Leposaviq/Leposavic	17
Zubin Potok/Zubin Potok	17
Zveçan/Zvecan	17
Novobërdë/Novo Brdo	17
Shtërpcë/Štrpce	17

10.3 Mandati i këshilltarëve të kuvendit komunal është i njëjtë sikurse mandati i kuvendit komunal, i përcaktuar me ligjin në fuqi mbi zgjedhjet komunale.

10.4 Të gjithë këshilltarët e kuvendit komunal kanë të drejta të njëjta dhe të barabarta dhe mundësi për të marrë plotësisht pjesë në proceset e Kuvendit. Kuvendi komunal siguron që këto të drejta dhe mundësi të përfshihen në Statutin dhe Rregulloren e punës.

Neni 11

Funksionet e kuvendit komunal

11.1 Kuvendi komunal miraton Statutin dhe e ndryshon atë nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme. Statuti rregullon zbatimin e përgjegjësive të komunës ashtu si është përcaktuar me këtë Rregullore. Vendimi për miratimin apo ndryshimin e Statutit duhet të miratohet me më shumë se dy të tretat e këshilltarëve të pranishëm që votojnë në mbledhjen ku shqyrtohet propozimi.

11.2 Kuvendi komunal e miraton Rregulloren e punës dhe mund ta ndryshojë atë nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme. Rregullorja e punës siguron menaxhimin efikas dhe kontrollin, duke përfshirë kontrollin efikas financiar të administratës së komunës. Vendimi për miratimin apo ndryshimin e Rregullores së punës duhet të miratohet nga më

shumë se gjysma e këshilltarëve të pranishëm që votojnë në mbledhjen ku shqyrtohet propozimi.

11.3 Kuvendi komunal nuk mund ta delegojë përgjegjësinë e vet për marrjen e vendimeve lidhur me:

- (a) miratimin e buxhetit;
- (b) miratimin e çështjeve të tjera financiare të cilat sipas Statutit dhe Rregulloreve të punës i janë rezervuar kuvendit;
- (c) kompensimet për këshilltarët e zgjedhur;
- (d) raportin vjetor;
- (e) miratimin, ndryshimin dhe anulimin e rregulloreve lokale komunale;
- (f) krijimin e komiteteve që kërkohen me këtë Rregullore;
- (g) zgjedhjen e zëvendëskrye suedit (ve) të kuvendit komunal;
- (h) emërimin e shefit të Departamentit të administratës dhe personelit;
- (i) lartësinë e tarifave dhe ngarkesave;
- (j) krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekorimeve dhe titujve të nderit, në përputhje me ligjin në fuqi;
- (k) emërtimin dhe riemërtimin e rrugicave, rrugëve dhe vendeve të tjera publike dhe
- (l) bërjen e planeve dhe marrëveshjeve në pajtim me kapitullin 1, neni 3.6.

11.4 Kuvendi komunal mund t'ia delegojë pushtetin për të marrë vendime një komiteti të kuvendit komunal ose kryetarit të komunës. Kuvendi i komunës mund të revokojë delegimin në çdo kohë. Kompetenca e deleguar mund të bartet edhe më tej brenda autoritetit të dhënë me këtë Rregullore.

11.5 Vendimi për emërtimin apo riemërtimin e çfarëdo rrugice, rruge apo vendi tjetër publik duhet të miratohet nga më së paku dy të tretat e këshilltarëve të kuvendit komunal.

Neni 12

Mbledhja e parë dhe betimi apo deklarata e këshilltarëve

12.1 Kuvendi komunal e mban mbledhjen e parë inauguruese brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e verifikimit të rezultateve të zgjedhjeve. Përfaqësuesi më i vjetër i kuvendit e kryeson çdo mbledhje deri sa kryetari ta ketë dhënë betimin apo deklaratën solemne.

12.2 Këshilltarët e kuvendit komunal duhet ta nënshkruajnë betimin apo deklaratën solemne. Forma e betimit apo deklaratës solemne është si vijon:

“Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i kuvendit të komunës së _____, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.”

Neni 13

Kryesuesi i kuvendit komunal dhe zëvendëskryesuesit

13.1 Kryetari i komunës ushtron funksionin e kryesuesit të kuvendit komunal. Ai i konvokon dhe i kryeson mbledhjet e kuvendit komunal. Mënyra e thirrjes dhe udhëheqjes së sesioneve të kuvendit rregullohet me Rregulloren e punës.

13.2 Kuvendi komunal ka zëvendëskryesuesin, i cili thirr dhe kryeson sesionet e kuvendit komunal në mungesë të kryetarit. Zëvendëskryesuesi zgjedhet nga shumica e këshilltarëve të kuvendit komunal. Komuna e Prishtinës do të ketë edhe një zëvendëskryesues shtesë të kuvendit komunal, i cili do të zgjedhet në të njëjtën mënyrë.

13.3 Në komuna ku jetojnë një apo më shumë komunitete të cilët nuk janë shumicë, kuvendi komunal zgjedh një zëvendëskryesues të dytë nga këshilltarët e kuvendit komunal nga këto komunitete, sipas një procedure të përcaktuar në Statutin e komunës. Nëse këto komunitete nuk kanë këshilltar në kuvendin komunal, kuvendi komunal e cakton një person nga këto komunitete, në konsultim me pjesëtarët e këtyre komuniteteve, për të shërbyer si zëvendëskryesues me të drejtë që të marrë pjesë dhe të flasë si këshilltar, pa të drejtë vote në mbledhjet e kuvendit komunal dhe në komitetet e tij.

13.4 Rregullorja e punës gjithashtu rregullon se kush konvokon dhe kryeson sesionet e kuvendit komunal nëse posti i kryetarit dhe zëvendëskryetarit(ëve) është i paplotësuar apo për çfarëdo arsye ata nuk mund të marrin pjesë.

Neni 14

Kuorumi dhe mbledhjet

14.1 Kuorumi për të gjitha mbledhjet e kuvendit komunal dhe komitetet e tij përbëhet nga gjysma e këshilltarëve të pranishëm në mbledhje me të drejtë pjesëmarrje dhe votimi.

14.2 Në të gjitha mbledhjet e kuvendit komunal dhe të komiteteve, të gjithë këshilltarët kanë vetëm një votë. Kur vepron si kryesues i kuvendit komunal, kryetari i komunës ka votën vendimtare në rast të numrit të njëjtë të votave për ose kundër ndonjë propozimi.

14.3 Kuvendi komunal dhe komitetet marrin vendime me votim të hapur, përveç nëse me këtë Rregullore kërkohet ndryshe.

14.4 Vendimet e kuvendit komunal dhe të komiteteve të tij merren me shumicën e thjeshtë të këshilltarëve të pranishëm dhe të cilët votojnë, përveç nëse me këtë Rregullore kërkohet ndryshe.

Neni 15 Mbledhjet

15.1 Kuvend komunal mbledhet sa herë që kjo parashihet me Rregulloren e punës, por duhet të mbajë së paku dhjetë mbledhje brenda vitit fiskal.

15.2 Mbledhjet e kuvendit komunal gjithashtu mund të thirren nga çereku i numrit të të gjithë këshilltarëve të zgjedhur ose nga komiteti i kuvendit.

15.3 Së paku shtatë ditë pune para çfarëdo mbledhjeje të kuvendit komunal ose ekskluzivisht tri ditë pune më herët në raste urgjente, këshilltarët e kuvendit duhet të njoftohen për kohën, datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes si dhe për rendin e ditës së asaj mbledhjeje. Njoftimet publike për këto çështje shpallen në të njëjtën kohë.

Neni 16 Procesverbali

16.1 Për të gjitha mbledhjet e kuvendit komunal dhe të komiteteve të tij mbahet procesverbali. Procesverbali përfshin emrat e këshilltarëve të pranishëm dhe anëtarëve të ftuar, rendin e ditës, thelbin e diskutimit, rezultatin numerik të votimit dhe propozimet e miratuara apo të refuzuara. Nëse kërkohet të thirret emri i çdo këshilltari, në procesverbal shënohet si ka votuar secili.

16.2 Procesverbalin e mban një shërbyes civil komunal, i caktuar nga shefi i Departamentit të administratës dhe personelit, i cili duhet të miratohet në mbledhjen e ardhshme. Çdokush ka të drejtë ta shikojë procesverbalin dhe ta marrë një kopje.

16.3 Kryesuesi e nënshkruan procesverbalin e miratuar.

Neni 17 Konfliktet e interesave – këshilltarët

17.1 Këshilltari i kuvendit komunal apo i komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij ka interes personal apo material.

17.2 Çdo këshilltar duhet t'i shfaqë të gjitha konfliktet e interesave që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve në të cilën është i pranishëm. Çdo këshilltar mund të ofrojë informacione që janë në interes të këshilltarit tjetër.

17.3 Çdo këshilltar mund të tërhiqet vullnetarisht nga procesi i marrjes së vendimeve dhe nga procedurat administrative, nëse konsideron se ato mund të çojnë deri te konflikti i interesave.

17.4 Këshilltarët e kuvendit komunal nuk mund të punësohen nga komuna në asnjë pozitë udhëheqëse.

17.5 Para mbledhjes së parë të kuvendit komunal, këshilltarët e kuvendit shënojnë në një deklaratë të plotë dhe të hapur interesat e tyre financiare dhe këtë regjistër e mban Departamenti i administratës dhe personelit. Këshilltarët shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare posa ato të ndodhin.

17.6 Kur ekzistojnë konflikte të interesave, Statuti dhe Rregullorja e punës përcaktojnë masat për përjashtimin e anëtarëve nga procesi i marrjes së vendimeve dhe nga procedurat administrative.

Neni 18

Kompetencat plotësuese të këshilltarëve të kuvendit komunal

Këshilltari i kuvendit komunal ka të drejtë të:

- (a) kërkojë informacione lidhur me çështjet komunale nga kryetari, zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal apo kryesuesi i komitetit. Kërkesa shqyrtohet në pajtim me procedurat që do të përcaktohen në Statut dhe në Rregulloren e punës.
- (b) dorëzojë vërejtje me shkrim të cilat do t'i bashkëngjiten procesverbalit.
- (c) diskutojë, por nuk mund të votojë në mbledhjet e komitetit të kuvendit në të cilat ai nuk është anëtar. Ai mund t'i propozojë kryesuesit të komitetit që të diskutohet ndonjë çështje që është në përgjegjësi të komitetit.

(d) kërkojë nga Bordi i drejtorëve të dhëna dhe ndihmë administrative të arsyeshme për punën e tij si drejtor. Nëse ai është i pakënaqur me përgjigje, ai mund t'ia gritë çështjen në Kuvendin komunal.

Neni 19

Punësimi dhe kompensimi

19.1 Punëdhënësit duhet t'u lejojnë këshilltarëve të kuvendit që të mungojnë nga vendet e tyre të punës për periudhën e arsyeshme kohore e cila nevojitet për punën e kuvendit.

19.2 Kuvendi komunal mund t'i shpërblejë këshilltarët e kuvendit, duke përfshirë edhe ata këshilltarë që mbajnë postin e kryetarit ose zëvendëskryetarit për punën e tyre në komunë me anë të kompensimit të shpenzimeve, humbjeve financiare ose një shume paushall, në pajtim me Statutin dhe ligjin në fuqi.

Neni 20

Shkarkimi

20.1 Këshilltari i kuvendit komunal i cili nuk e nënshkruan betimin ose deklaratën brenda një muaji pas zgjedhjes pushon të jetë këshilltar.

20.2 Këshilltari i kuvendit komunal i cili ka qenë i dënuar për veprë penale të dënueshme me tre muaj burgim dhe është lëshuar urdhri për burgim pushon të jetë anëtar.

20.3 Nëse këshilltari i kuvendit komunal nuk merr pjesë gjashtë muaj rresht në mbledhje të kuvendit komunal ose në komitetet e tij, ai pushon të jetë anëtar, përveç nëse ka munguar me arsye të miratuar nga kuvendi komunal.

20.4 Nëse një këshilltar i kuvendit komunal e humb të drejtën për t'u zgjedhur në kuvendin komunal ai pushon të jetë këshilltar.

Neni 21

Komitetet e përhershme dhe komitetet tjera

21.1 Kuvendi komunal krijon si komitet të përhershëm Komitetin për politikë dhe financa, Komitetin për komunitete dhe Komitetin për ndër-mjetësim, siç kërkohet me këtë Rregullore.

21.2 Kuvendi komunal themelon edhe komitete të tjera si komitete të përhershme sikurse Komitetin për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, Komitetin për arsim dhe kulturë, Komitetin për Zhvillim ekonomik, Komitetin për planifikim urban, kadastër dhe mbrojtjen e ambientit dhe mund të krijojë edhe komitete të tjera dhe të vendosë për kompetencat dhe veprimtaritë e tyre.

21.3 Gjatë caktimit të anëtarëve të komiteteve të përhershme dhe të komiteteve të tjera, Kuvendi komunal bën përpjekje që të sigurojë baraspeshë gjinore në të gjitha komitetet.

21.4 Komitetet e krijuara sipas nenit 21.2 mund të shtojnë në radhët e tyre individë që nuk janë këshilltarë të kuvendit komunal, por shumica e anëtarëve të komiteteve duhet të jenë gjithmonë këshilltarë të kuvendit komunal.

21.5 Anëtarësimi në çdo komitet duhet të pasqyrojë në mënyrë sa më të përafërt proporcionin e vendeve që i mbajnë partitë politike dhe koalicionet në kuvendin komunal, përveç rasteve kur me këtë Rregullore kërkohet ndryshe.

21.6 Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i çdo komiteti zgjedhet nga anëtarët dhe prej anëtarëve të komitetit, përveç rasteve kur me këtë Rregullore kërkohet ndryshe.

21.7 Çdo komitet vendos për kohën e mbajtjes së mbledhjeve në pajtim me Rregulloren e punës.

21.8 Mbledhja e komitetit konvokohet nëse kryesuesi i komitetit mendon se kjo është e nevojshme ose me kërkesën me shkrim të së paku një të tretës së anëtarëve të tij.

Neni 22

Komiteti për politikë dhe financa

22.1 Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për propozimin e buxhetit dhe për formulimin dhe hulumtimin e drejtimit strategjik të komunës në të ardhmen.

22.2 Kryetari i komunës drejton mbledhjet e komitetit. Kur kryen detyrën e kryesuesit kryetari ka të drejtën e votës vendimtare nëse ka numër të barabartë të votave për dhe kundër propozimit. Në mungesë të kryetarit, Komitetin e kryeson një zëvendëskryesues i kuvendit komunal, në pajtim me dispozitat e parapara në Rregulloren e punës.

22.3 Kryesuesit e komiteteve të tjera janë të autorizuar të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit për politikë dhe financa.

Neni 23

Komiteti për komunitete, Komiteti për ndërmjetësim dhe Zyra për komunitete

23.1 Të drejtat e Komitetit të komuniteteve të parapara në këtë nen janë shtesë e të drejtave të anëtarit të Komitetit apo të komunitetit ose të qytetarit, i cili mund ta paraqesë çështjen te Avokati i Popullit apo në gjykatë.

23.2 Me Statut rregullohen procedurat për caktimin e anëtarëve në Komitetin e komuniteteve dhe në Komitetin për ndërmjetësim. Procedurat duhet të garantojnë që:

(a) anëtarësia e Komitetit të komuniteteve të përfshijë anëtarë të kuvendit dhe përfaqësues të komuniteteve;

(b) çdo komunitet që jeton në komunë të përfaqësohet së paku me nga një anëtar në Komitetin e komuniteteve;

(c) komuniteti i cili është shumicë në komunë të ketë më pak se gjysmën e numrit të anëtarëve të Komitetit të komuniteteve dhe që pjesa tjetër e anëtarëve të Komitetit të komuniteteve të pasqyrojë qartë numrin e komuniteteve tjera në komunë dhe

(d) Komiteti për ndërmjetësim të ketë numër të barabartë të:

(i) këshilltarëve të kuvendit komunal të cilët nuk janë anëtarë të Komitetit të komuniteteve dhe

(ii) të përfaqësuesve në përpjesëtim të drejtë me komunitetet e komunës, të cilët nuk i takojnë komunitetit që është shumicë në komunë.

23.3 Komiteti i komuniteteve bën përpjekje në kuadër të territorit të komunës të sigurojë që:

(a) asnjë person i cili merr përsipër detyra publike ose mban post publik të mos guxojë të bëjë diskriminim ndaj asnjë personi në asnjë bazë, për shkak të gjuhës, përkatësisë etnike ose lidhjes me komunitetin;

(b) të gjithë personat të gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtat civile, politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe mundësi të drejtë e të barabartë punësimi në shërbimet komunale në të gjitha nivelet;

(c) shërbimi civil komunal të pasqyrojë në proporcion të drejtë numrin e përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve në të gjitha nivelet.

23.4 Komiteti i komuniteteve i përkrah të drejtat dhe interesat e komuniteteve që jetojnë në atë komunë dhe veç kësaj përkrah një shoqëri ku traditat e ndryshme kulturore, shoqërore dhe fetare jo vetëm që do të tolerohen por edhe do të inkurajohen.

23.5 Nëse Komiteti i komuniteteve mendon se është ndërmarrë ose është propozuar që të ndërmerret ndonjë veprim nga ose në emër të kuvendit komunal, i cili ka shkelur ose mund t'i shkelë të drejtat e një komuniteti a të një pjesëtari të komunitetit ose i cili mund të jetë i dëmshëm për interesat e komunitetit, çështjen duhet t'ia paraqesë menjëherë Komitetit për ndërmjetësim.

23.6 Komiteti për ndërmjetësim i shqyrton të gjitha çështjet të cilat Komiteti i komuniteteve ia parashtron. Ky komitet kryen aso hetime të nevojshme për të konstatuar se a

janë shkelur apo mund të shkelen të drejtat e një komuniteti ose pjesëtari të një komuniteti, apo nëse është ndërmarrë apo propozuar ndonjë masë ndaj atij veprimi që është apo mund të jetë i dëmshëm për interesat e komunitetit. Komiteti kërkon që rastin ta zgjidhë me ndërmjetësim. Komiteti për ndërmjetësim i paraqet raport kuvendit komunal brenda afatit prej 28 ditësh për çdo çështje, duke dhënë rekomandime lidhur me shqyrtimin e asaj çështjeje.

23.7 Kuvendi komunal shqyrton çdo raport që i dorëzohet nga Komiteti për ndërmjetësim dhe vendos se çfarë veprimi duhet të ndërmerret tani apo në të ardhmen lidhur me atë rast. Vendimi i Komitetit duhet të jetë në pajtim me ligjin dhe me parimet e parapara në këtë Rregullore, e veçmas me ato të parapara në kapitullin 1, nenin 2.3, në këtë nen 23 dhe në kapitullin 5, neni 33.

23.8 Nëse kuvendi komunal nuk arrin të bie vendim sipas nenit 23.8 brenda afatit prej 21 ditësh pas dorëzimit të raportit të Komitetit për ndërmjetësim, ose nëse Komiteti i komuniteteve është i pakënaqur me vendimin e kuvendit komunal sipas nenit 2.3, vendimi mund t'i dorëzohet për shqyrtim Gjykatës Supreme të Kosovës.

23.9 Gjatë kryerjes së detyrave dhe ushtrimit të pushtetit të tyre sipas kapitullit 1, neni 5, komunat i kushtojnë kujdes të veçantë përmbushjes së nevojave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, të cilat janë të banuara me komunitete që nuk janë shumicë në atë komunë.

23.10 Zyra për komunitete themelohet në ato komuna ku komuniteti i cili nuk është shumicë përbën një pjesë të konsiderueshme të popullsisë.

23.11 Zyra për komunitete është përgjegjëse për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve dhe sigurimin e qasje s së barabartë të komuniteteve në shërbimet publike në nivel komunal.

23.12 Zyra për komunitete është pjesë integrale e komunës dhe e strukturës së administratës komunale. Atë e themelon komuna. Nën-zyrat do të themelohen nëse do të jenë të nevojshme për të ofruar shërbime publike të sigurta dhe të lira.

23.13 Shefi i zyrës për komunitete është anëtar i Bordit të drejtorëve të komunës sipas detyrës zyrtare. Ai paraqet raportin në secilën mbledhje të Komitetit të komuniteteve, duke përshkruar në detaje punët e kryera për të cilat është përgjegjëse ajo zyre e komuniteteve.

Kapitulli 3 Kryetari i komunës

Neni 24 Zgjedhja e kryetarit të komunës

24.1 Kryetari i komunës zgjedhet drejtpërdrejt nga njerëzit që kanë të drejtë vote në komunë në përputhje me Ligjin mbi zgjedhjet komunale që është në fuqi.

24.2 Kryetari i komunës zgjedhet për mandat të njëjtë sikurse këshilltarët e kuvendit. Asnjë person nuk do të shërbejë më tepër se dy mandate si kryetar i komunës.

24.3 Kur kryetari i komunës mungon përkohësisht ose kur përkohësisht nuk ka mundësi të ushtrojë funksionin e kryetarit, ai e cakton një anëtar të Bordit të drejtorëve që përkohësisht të ushtrojë funksionin e kryetarit, me përjashtim të funksioneve që i janë besuar nënkryetarit të kuvendit komunal në pajtim me nenin 13.2.

24.4 Kuvendi komunal siguron mjete në buxhetin komunal për kompensimin e kryetarit të komunës në pajtim me ligjin në fuqi.

Neni 25

Dhënia e betimit ose e deklaratës për postin e kryetarit të komunës

Me rastin e zgjedhjes, kryetari i komunës e jep betimin apo deklaratën solemne përpara këshilltarëve të kuvendit komunal. Forma e betimit ose deklaratës është si vijon:

“Beto hem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej detyrat dhe do t’i ushtroj kompetencat e mia si kryetari i komunës së _____ me nder, besnikëri, paanshmëri, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të sigurohen kushte për një jetë të qetë për të gjithë.”

Neni 26

Shkarkimi nga posti dhe zgjedhja e kryetarit të ri të komunës

Mandati i kryetarit të komunës mund të përfundojë vetëm sipas mënyrës së përcaktuar me Ligjin aktual mbi zgjedhjet komunale. Në rast të përfundimit para skadimit të rregullt të mandatit të kryetarit, pa vonesë mbahen zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të asaj komune.

Neni 27

Përgjegjësitë

27.1 Kryetari i komunës krye n funksionin e kryesuesit të kuvendit komunal.

27.2 Në konsultim me kuvendin komunal, kryetari emëron drejtorët për ta ndihmuar kryetarin në kryerjen e detyrave të tij. Gjatë këtyre emërimeve, kryetari do t’i kushtojë vëmendjen e duhur përfaqësimit të drejtë të komuniteteve që jetojnë në komunë. Personat e emëruar shërbejnë si anëtarë të Bordit të drejtorëve siç është përcaktuar në nenin 30.

27.3 Kryetari i komunës kryen funksionin e kryesuesit të Bordit të drejtorëve, i cili i ndihmon kryetarin që të ushtrojë përgjegjësitë e tij.

27.4 Kryetari është përgjegjës për t’ia propozuar kuvendit komunal buxhetin vjetor për miratim.

27.5 Kryetari i komunës është përgjegjës për zbatimin e rregulloreve të miratuara dhe vendimeve të marra nga kuvendi komunal dhe për administrimin financiar të komunës.

27.6 Kryetari ia paraqet për shqyrtim Komitetit të komuniteteve çdo çështje që ka të bëjë me të drejtat ose interesat e komuniteteve.

27.7 Kryetari i komunës i raporton kuvendit komunal të paktën çdo tre muaj.

27.8 Kryetari do të ketë edhe ato përgjegjësi që i caktohen atij në pajtim me këtë Rregullore, me Statut dhe në bazë të Rregullores së punës të miratuar nga kuvendi komunal.

Neni 28

Konflikti i interesave -kryetari

28.1 Dispozitat e kapitullit 2, nenit 17 zbatohen përshtatshmërisht për kryetarin e komunës.

28.2 Pas zgjedhjes, kryetari duhet të përfundojë sa më shpejt që është e mundur çdo kontratë ose lidhje e cila mund ta vë në dyshim mundësinë e kryerjes së obligimeve të tij në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

Kapitulli 4

Drejtoria komunale dhe Bordi i drejtorëve

Neni 29

Drejtoria komunale

29.1 Në bazë të Statutit komunal themelohen drejtoria komunale të cilat përfshijnë Drejtorinë e administratës dhe personelit, Drejtorinë e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, Drejtorinë e arsimit dhe kulturës, Drejtorinë e financave, ekonomisë dhe zhvillimit, Drejtorinë e urbanizmit, kadastrës dhe mbrojtjes së mjedisit, Zyrën komunale për komunitete dhe ndonjë drejtori tjetër që konsiderohet e nevojshme dhe e duhur për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi të komunës.

29.2 Kryetari emëron drejtorin për secilën drejtori në pajtim me nenin 27, i cili do të jetë përgjegjës për drejtimin dhe udhëheqjen e drejtorisë komunale, përveç Drejtorisë së administratës dhe personelit, e cila funksionon nën drejtimin dhe udhëheqjen e shefit të Drejtorisë nën autorizimet e përgjithshme të kuvendit komunal dhe të kryetarit.

29.3 Një drejtori mund t'i caktohet përgjegjësia për të udhëhequr më shumë se një (1) drejtori.

29.4 Drejtorët janë të emëruar politik për mandat të njëjtë me kryetarin e komunës dhe konsiderohen "të emëruar të lirë" sipas nenit 1 (e) të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi shërbimin civil të Kosovës.

29.5 Secila drejtori komunale që përbëhet nga shërbyes civil komunalë e ka një drejtues të punësuar në përputhje me ligjin në fuqi mbi shërbimin civil në Kosovë.

Neni 31

Bordi i drejtorëve

30.1 Bordi i drejtorëve përbëhet prej drejtorëve të emëruar nga kryetari, nga drejtuesi i Drejtorisë së administratës dhe personelit dhe nga drejtuesi i Zyrës për komunitete, të cilët shërbejnë si anëtarë sipas detyrës zyrtare:

30.2 Secili anëtar i Bordit të drejtorëve, duke përjashtuar anëtarët sipas detyrës zyrtare, i:

- (a) raporton rregullisht kryetarit për çështjet që janë nën përgjegjësinë e tij;
- (b) ndihmon kryetarit, kuvendit komunal dhe komiteteve të tij duke iu ofruar të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes dhe
- (c) zbaton të gjitha rregulloret dhe vendimet e komunës.

Neni 31

Konflikti i interesit - Bordi i drejtorëve

31.1 Një anëtar i Bordit të drejtorëve përjashtohet nga marrja e vendimeve dhe nga procedurat administrative që kanë të bëjnë me çfarëdo çështjesh për të cilën ai apo ndonjë anëtar i ngushtë i familjes së tij ka ndonjë interes personal ose financiar.

31.2 Nga drejtorët kërkohet që të paraqesin me shkrim çdo konflikt interesash në një regjistër të cilin e mban Drejtorja e administratës dhe personelit.

31.3 Statuti dhe Rregullorja e punës përfshijnë masat të cilat merren për të përjashtuar anëtarët e Bordit të drejtorëve nga vendimmarrja dhe procedurat administrative ku ata kanë ndeshje interesash.

Kapitulli 5

Shërbimi civil komunal

Neni 32

Shërbimi civil komunal

32.1 Personeli administrativ përbën shërbimin civil komunal, i cili udhëhiqet në pajtim me Ligjin në fuqi mbi shërbimin civil në Kosovë.

32.2 Kushtet e shërbimit civil komunal duhet të jenë të tilla që të mundësojnë punësimin e personelit të nivelit të lartë në bazë të meritës dhe aftësisë.

32.3 Të gjithë nëpunësit civil komunal i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të paanshme dhe të drejtë duke respektuar dhe duke vepruar në pajtim me ligjin.

32.4 Të gjithë nëpunësit civil komunal i zbatojnë udhëzimet e eprorëve të tyre dhe i përfillin urdhrat e tyre, përveç nëse detyrat e dhëna janë në kundërshtim me ligjin ose me të drejtat dhe liritë e njeriut dhe me të drejtat e komuniteteve.

32.5 Shërbimi komunal në të gjitha nivelet duhet të pasqyrojë në mënyrë proporcionale numrin e përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve.

32.6 Nga të gjithë nëpunësit civil komunal kërkohet t'i paraqesin me shkrim të gjitha konfliktet e interesave në një regjistër të cilin e ruan Drejtoria e administratës dhe personelit.

32.7 Shefi i një detyrie komunale, i një zyre ose seksioni nuk mund të jetë këshilltar i kuvendit komunal në komunën ku punon.

Neni 33

Drejtoria e administratës dhe personelit

33.1 Kuvendi komunal emëron shefin e Drejtorisë së administratës dhe personelit përshtatshëmrisht (*mutas mutandis*) në pajtim me procedurat për zgjedhjen dhe punësimin e shërbyesve të lartë civil të përcaktuar sipas ligjit në fuqi. Shefi i Drejtorisë së administratës dhe personelit duhet t'i ketë kualifikimet e përshkruara me Statut dhe kryen funksionin e shërbyesit të lartë civil në komunë.

33.2 Shefi i Drejtorisë së administratës dhe personelit, duke vepruar nën autorizimet e përgjithshme të kuvendit komunal dhe kryetarit të komunës:

- (a) kryen detyrën e sekretarit të kuvendit komunal
- (b) kryen detyrën e sekretarit të Bordit të drejtorëve
- (c) ushtron të gjitha përgjegjësitë që i caktohen me këtë Rregullore, me Statut ose me Rregulloren e punës dhe
- (d) ushtron të gjitha përgjegjësitë që i caktohen nga kryetari ose nga kuvendi komunal.

33.3 Shefi i Drejtorisë së administratës dhe personelit, sapo të ketë mundësi e njofton kuvendin komunal dhe kryetarin për ndonjë veprim të ndërmarrë ose të propozuar që mund të jetë në kundërshtim me ligjin ose me procedurat buxhetore, me rregulloret financiare ose me rregullat e prokurimit, ose i cili nuk është në pajtim me këtë Rregullore, me Statutin dhe me Rregulloren e punës.

33.4 Shefi i Drejtorisë së administratës dhe personelit kryen detyrën e shefit të personelit të shërbimit civil komunal. Emërimi, kushtet e shërbimit dhe largimi i të gjithë shërbyesve civil komunal menaxhohet nga ai në përputhje me ligjin në fuqi.

33.5 Nëse pozita e shefit të Drejtorisë së administratës dhe personelit mbetet e zbrazët, kuvendi komunal, brenda periudhës prej tre muajve, cakton një shef të ri sipas nenit 32.1.

33.6 Shefi i Drejtorisë së administratës dhe personelit mund të shkarkohet vetëm sipas mënyrës së parapare për shkarkimin e zyrtarëve të lartë komunal sipas ligjit në fuqi.

Kapitulli 6

Ankesat dhe mbrojtja juridike

Neni 34

Parimi i ligjshmërisë

Administrata e komunës është e obliguar të respektojë ligjin dhe drejtësinë, dhe në veçanti të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të paraqitura në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe protokollet e saj. Të gjitha veprimet administrative duhet të jenë në pajtim me ligjin në fuqi.

Neni 35

Ankesat

35.1 Personi mund të parashtojë ankesë rreth ndonjë vendimi administrativ të një komune nëse ai konsideron se me atë vendim janë shkelur të drejtat e tij. Ankesat duhet t'i parashtrihen me shkrim shefit të Drejtorisë së administratës dhe personelit ose të dorëzohen personalisht në zyrën e shefit të Drejtorisë së administratës dhe personelit, brenda afatit prej një muaji nga dita kur parashtruesi i ankesës të jetë njoftuar me vendimin.

35.2 Shefi i Drejtorisë së administratës dhe personelit e rishqyrton ligjshmërinë e vendimit si dhe procesin administrativ me të cilin është arritur ai vendim. Ai brenda afatit prej dy (2) javësh i rekomandon kryetarit të komunës, i cili është përgjegjës që parashtruesit të ankesës t'i jap një përgjigje të arsyetuar me shkrim brenda afatit prej një muaji nga dita e pranimit të ankesës, që t'i përgjigjet atij dhe ai vendim administrativ është përfundimtar.

35.3 Nëse nuk është i kënaqur me përgjigjen e kryetarit të komunës, parashtruesi i ankesës mund të kërkojë që të bëhet shqyrtimi gjyqësor në gjykatën kompetente, në pajtim me ligjin në fuqi.

35.4 Asnjë vendim administrativ nuk mund të ndërrohet në dëm të parashtruesit të ankesës si pasojë e ankesës.

35.5 Të drejtat e përcaktuara me këtë nen janë të drejta shtesë të çfarëdo të drejtave të cilat personi mund t'i ketë për t'ia paraqitur një vendim administrativ Avokatit të Popullit apo ndonjë gjykate.

Neni 36

Mbrojtja gjyqësore e ligjit

Qytetari mund të kërkojë zgjidhje për vendimet e ndonjë komune, në pajtim me rregullat dhe procedurat e gjykatës përkatëse.

Kapitulli 7

Administrimi financiar

Neni 37
Parimet e përgjithshme

37.1 Buxheti i komunës duhet të jetë i balancuar, i përgatitur në mënyrë transparente dhe i bazuar në kritere objektive.

37.2 Buxheti duhet të përmbajë planin për aktivitete dhe udhëheqje ekonomike brenda vitit fiskal dhe duhet të përfshijë të gjitha parashikimet e të hyrave, shpenzimet kapitale dhe ato të përditshme të komunës. Ai gjithashtu duhet t'i ndajë fondet ekzistuese për nevojat e shpenzimeve të komunës.

37.3 Statuti dhe Rregullorja e punës i përcaktojnë procedurat buxhetore, standardet financiare dhe rregullat e prokurimit që i plotësojnë kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi.

Neni 38
Fondet e komunës

38.1 Qeveria, përmes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, bën transferime financiare për komunën duke u bazuar në kritere objektive, përfshirë edhe vlerësimin e nevojave dhe burimeve financiare për çdo komunë dhe prioritetet e shpenzimeve të përcaktuara sipas ligjit në fuqi.

38.2 Një pjesë e fondeve të transferuara mund të ndahet për veprimtari specifike të përcaktuara në kapitullin 1, neni 3. Një pjesë e fondeve të transferuara nuk ndahet fare.

38.3 Komuna njoftohet për shumën e fondeve të transferuara për vitin e ri fiskal në përputhje me procedurat e përcaktuara sipas ligjit në fuqi.

Neni 39
Të hyrat komunale

39.1 Komuna mund të mbledhë të hyra në përputhje me ligjin në fuqi nga:

- (a) licencat dhe pagesat që i cakton dhe i vë komuna;
- (b) të ardhurat dhe pasuria e komunës dhe
- (c) gjobat apo përqindja e gjobave.

Neni 40
Shërbimet komunale të ofruara nga ndërmarrjet komunale

40.1 Kur shërbimet komunale kryhen nga ndërmarrjet komunale këto ndërmarrje duhet t'ia paraqesin kuvendit komunal buxhetin e tyre për miratim. Buxheti i propozuar duhet të përfshijë strukturën e tarifës së propozuar për ofrimin e shërbimeve dhe duhet të dorëzohet deri më 1 dhjetor para vitit të ardhshëm fiskal.

40.2 Kur një ndërmarrje ofron shërbime komunale lokale për më shumë se një komunë, atëherë ato komuna duhet të merren vesh për mbikëqyrjen e përbashkët të veprimtarisë së asaj ndërmarrje.

Neni 41 Miratimi i buxhetit

Viti fiskal i komunës fillon më 1 janar. Kryetari i komunës ia paraqet kuvendit komunal buxhetin për miratim sa më shpejt që praktikisht është e mundur, pas njoftimit për lartësinë e fondit të ndarë për vitin vijues.

Neni 42 Raporti vjetor

42.1 Komuna e publikon raportin vjetor pas përfundimit të çdo viti fiskal të komunës. Raporti i prezantohet kuvendit komunal për miratim jo më vonë se 30 maj të vitit vijues. Raporti duhet të përmbledhë objektivat e komunës në lidhje me veprimtaritë e saj për të cilat është përgjegjëse dhe duhet të vlerësojë nivelin e realizimit të objektivave për atë vit fiskal. Raporti duhet të sqarojë mënyrën e financimit të secilit prej aktiviteteve dhe duhet të tregojë gjendjen financiare të komunës në fund të atij viti fiskal. Ai duhet të përfshijë edhe deklaratat mbi kontrollin financiar. Këto kërkesa duhet të përfshijnë edhe veprimtaritë e ndërmarrjeve komunale, përkrahjen e dhënë organizatave jofitimprurëse si dhe marrëveshjet e bëra me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Neni 43 Kontrolli i pavarur financiar

43.1 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm cakton një auditor të pavarur financiar me qëllim të kontrollimit të raporteve financiare të çdo komune.

43.2 Auditori ka të drejtë t'i shikojë të gjitha deklaratat financiare, librat, shkresat dhe dokumentet tjera dhe mund t'i kërkojë të gjitha të dhënat të cilat i duhen atij për kryerjen e kontrollit.

43.3 Auditori i kontrollon të gjitha raportet financiare të ndërmarrjeve komunale.

43.4 Auditori i kontrollon të gjitha raportet financiare të të gjitha organizatave të cilat marrin ndihmë financiare nga komunat.

43.5 Çdokush mund t'i paraqesë ankesë auditorit lidhur me raportet financiare dhe çështjet tjera financiare të komunës dhe auditori mund të bëjë hetime lidhur me ato.

43.6 Auditori i dorëzon kuvendit komunal raport me shkrim për çdo kontroll financiar dhe kuvendi komunal merr vendim për veprimet që duhet të ndërmerren lidhur me secilin rekomandim që përfshin raportin. Kuvendi nuk mund ta refuzojë pa arsye të mjaftueshme asnjërin prej rekomandimeve dhe arsyet duhet të shënohen në procesverbalin e mbledhjes përkatëse.

43.7 Çdo raport i auditorit duhet të bëhet publik.

Kapitulli 8

Pasuria e Komunës

Neni 44

Toka dhe objektet

44.1 Shefi i Drejtorisë së administratës dhe personelit kujdeset për përgatitjen dhe mbajtjen e shënimeve për tërë tokën dhe objektet të cilat i posedon apo i shfrytëzon komuna.

44.2 Komuna nuk mund të shesë apo të japë me qira tokën ose objektet komunale që janë nën menaxhimin ose kontrollin e saj për më shumë se dhjetë vjet pa miratimin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 45

Pasuritë e tundshme

Shefi i Drejtorisë së administratës dhe personelit siguron përgatitjen dhe mbajtjen e një inventari të mjaftueshëm për tërë pasurinë e tundshme që posedon komuna.

Kapitulli 9

Dispozitat e veçanta

Neni 46

Pushteti i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm

46.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm e mban tërë pushtetin që i është dhënë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Ai e ka fjalën përfundimtare në marrjen e vendimeve përkitazi me çdo dispozitë të kësaj Rregulloreje.

46.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të anulojë çdo vendim të komunës nëse konsideron se ai është në kundërshtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo ligjet tjera në fuqi, dhe nëse ato vendime nuk i marrin parasysh atë sa duhet të drejtat dhe interesat e komuniteteve që jetojnë në territorin e asaj komune.

46.3 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të përfshijë anëtarë plotësues në kuvendin komunal nëse këtë e konsideron të nevojshme për të siguruar përfaqësimin e të gjitha komuniteteve në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

46.4 Në raste të veçanta, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund t'i shkarkojë nga detyra këshilltarët e kuvendit komunal ose kryetarin e komunës për shkak të sjelljeve shumë të këqija gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Këshilltari i cili është shkarkuar nga detyra mund të kërkojë nga Avokati i Popullit ta shqyrtojë këtë vendim.

46.5 Nëse Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm konstaton se kuvendi komunal vazhdimisht ndërmerr veprime të cilat nuk mund të sigurojnë kushte për jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës, që janë në kundërshtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ai mund ta shkarkojë kuvendin komunal dhe të urdhërojë mbajtjen e zgjedhjeve të reja.

46.6 Një anëtar i shërbimit civil të komunës mund të shkarkohet nëse nuk i ka zbatuar detyrat e tij në mënyrë të paanshme dhe të drejtë, duke mos respektuar dhe vepruar në pajtim me ligjin në fuqi.

Neni 47

Përgjegjësitë e UNMIK -ut për monitorimin, drejtimin dhe këshillimin e komunave

47.1 Përfaqësuesit komunalë dhe zyrtarët e tjerë të caktuar nga UNMIK-u monitorojnë, drejtojnë dhe këshillojnë komunat dhe përgatisin raportet e nevojshme për PSSP-në për të siguruar që vendimet e komunës të jenë në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe me ligjet në fuqi.

47.2 Përfaqësuesit komunaë dhe zyrtarët e tjerë të caktuar nga UNMIK-u monitorojnë, drejtojnë dhe këshillojnë komunat që të garantojnë respektimin e parimeve themelore të të drejtave të njeriut dhe trajtimin e tyre të barabartë, dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

47.3 Përfaqësuesit komunaë dhe zyrtarët e tjerë të caktuar nga UNMIK-u i këshillojnë komunat për të ndihmuar në krijimin e kushteve lokale për kthimin e personave të zhvendosur brenda vendit dhe refugjatëve në komunat nga e kanë prejardhjen, dhe në aktivitetet për ndërtimin e paqes dhe në programet dhe aktivitetet e pajtimit.

47.4 Përfaqësuesit komunaë dhe zyrtarët e tjerë të caktuar nga UNMIK-u kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të mbajnë fjalime para kuvendit komunal, komiteteve të tij dhe Bordit të drejtorëve, si dhe kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin çfarëdo shënimi, përfshirë edhe të gjitha dokumentet zyrtare nga të gjitha organet e komunës si dhe nga shërbimi civil i komunës.

Neni 48

Interpretimi

Dispozitat e kapitullit 1 deri 8 të kësaj Rregulloreje hyjnë në fuqi në varësi të dispozitave të kapitullit 9. Aty ku ekziston mospërputhje në mes të dispozitave në kapitujt 1 deri 8 dhe cilësdo dispozitë në kapitullin 9, vlen dispozita në kapitullin 9.

Kapitulli 10

Prania e sigurisë ndërkombëtare

Asgjë në këtë Rregullore nuk mund të ndikojë në pushtetin e Komandantit të Forcës së Kosovës (KFOR) për të përmbushur të gjitha detyrat në mandatin e KFOR-it sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Kapitulli 11

Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhra administrative lidhur me zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Kapitulli 12 **Dispozitat kalimtare**

Neni 49

49.1 Posti i kryeshefit ekzekutiv dhe ato të shefave të drejtorive komunale do të pushojnë pas zgjedhjes së kryetarit të komunës dhe pas emërimit të anëtarëve të Bordit të drejtorëve.

49.2 Postet e shefave të drejtorive komunale do të plotësohen pa vonesë në pajtim me Ligjin në fuqi mbi shërbimin civil në Kosovë, siç është përcaktuar në nenin 29.5.

Kapitulli 13 **Ligji në fuqi**

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Kapitulli 13 **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 16 tetor 2007.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm